

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegj i përbërë nga gjyqtarët: Erdogan Haxhibeqiri, kryetar i kolegjit, Gyltene Sylejmani dhe Isa Kelmendi , anëtarë, në çështjen juridike të paditësit N. O., nga ..., të cilin me autorizim e përfaqëson N. H., av. nga Prishtina, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës, (KEK), sh.a. me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Zenel Shala, objekti i kontestit anulimi i vendimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe kthimit në punë, duke vendosur sipas revizionit të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4665/2016 datë 20.11.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 18.6.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Pjesërisht pranohet si i bazuar revizioni i të paditurës , i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4665/2016 datë 20.11.2017 përkitazi me pjesën e II të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr 1043/13 të datës 08.08.2016, me të cilën detyrohet e paditura që paditësit të njeh të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës dhe lënda në këtë pjesë si dhe për shpenzimet procedurale i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

II. REFUZOHET si i pa bazuar revizioni i të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4665/2016 datë 20.11.2017 përkitazi me pjesën e I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr 1043/13 të datës 08.08.2016, që ka të bëjë me anulimin e aktvendimit të Komisionit Disiplinor shkallës së parë të paditurës 188 të datës 02.02.2007 dhe Komisionit Disiplinor shkallës së dytë Nr. 1184 të datës 28.02.2007 me të cilën paditësit është ndërpre kontrata e punës dhe kthimit të paditësit në punë .

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4665/2016 datë 20.11.2017, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, -Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1043/2013 datë 08.8.2016 me të cilën është aprovuar kërkesëpadia e paditësit dhe është anuluar si i kundërligjshëm vendimi i Komisionit disiplinor të paditurës nr..., datë ..., dhe vendimi i Komisionit disiplinor i shkallës së dytë nr. ..., të datës ..., me të cilën paditësit i është ndërprerë kontrata e punës dhe detyrohet e paditura që paditësin ta kthejë në detyrat e punës që i ka kryer më parë apo në punë të ngjashme sipas aftësive punuese me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës , duke filluar nga 7.2.2007 si dhe të paguaj shpenzimet procedurale në shumë prej 1235 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura në afatin ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të dy aktgjykimet të ndryshohen dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditësit.

Paditësi nuk ka paraqitur përgjigje në revizionin e të paditurës.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimit të goditur dhe vlerësimit të thënieve në revizion, sipas dispozitës së nenit 215 të LPK-së, gjeti se:

Revizioni i të paditurës, është i pabazuar.

Në procedurë të zhvilluar pranë gjykatës së shkallës së parë, është vërtetuar se paditësi te e paditura ka qenë në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar në detyrat e punës inxhinier AUF-operator i mëditjeve në Departamentin “Kosova B”. Me vendimin e Komisionit disiplinor të paditurës nr. 188 të datës 2.2.2007, është shpallë përgjegjës për shkelje të rëndë të detyrave të punës, sepse në bashkëveprim me punëtorin Sh. M., në periudhën shkurt-nëntor 2006, ka ndërhyrë në regjistrat e urdhëresave të punës duke shënuar punë jashtë orarit të punës e që për këtë shkelje i është shqiptuar masa disiplinore ndërprerja e marrëdhënies së punës. Kundër këtij vendimi paditësi ka paraqitur ankesë të cilën me vendimin e Komisionit disiplinor të shkallës së dytë nr. 1184 datë 28.2.2007, i është refuzuar ankesa. Paditësi gjatë gjithë procedurës disiplinore dhe mbrojtjes së tij para gjykatës ka mohuar faktin se ai personalisht ka bërë ndërhyrje në regjistrat e urdhrave të punës por kjo është bërë nga eprori i tij. Ndërsa, e paditura në përgjigje në

padi ka deklaruar se përgjegjësia e paditësit është vërtetuar në procedurën disiplinore në bazë të provave të administruara.

Në këtë gjendje të vërtetuar faktike, gjykata e shkallës së parë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vlerësuar se në procedurë të zhvilluar te e paditura si dhe me provat e administruara nga ana e gjykatës, nuk është vërtetuar se në çfarëdo mënyre paditësi ka ndërhyrë në urdhëresat për pagesat e punës jashtë orarit të rregullt as që ka shkaktuar dëm material të paditurës. Këtë vlerësim gjykata e bazon në deklaratat e dëshmitarit I. H., si udhëheqës i drejtpërdrejtë i paditësit i cili ka pranuar se për paditësin ka nënshkruar urdhëresat për katër raste për punë jashtë orarit të punës, për këtë ka vërtetuar edhe dëshmitari Sh. M., i cili ka pohuar se këto urdhëresa i ka nënshkruar dhe përpiluar vet si drejtues i njësisë së punëtorëve. Fakti se nuk ka pasur ndërhyrje në urdhëresa për punë jashtë orarit të punës, kanë vërtetuar edhe grupi i ekspertëve të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës në përbërje nga ekspertët prof.dr.M. A., prof.dr. S. A. dhe mr.sci. A. S., ku kanë vërtetuar se nuk ka pasur ndërhyrje në urdhëresat e punës jashtë orarit të punës. Sipas kësaj gjykata e shkallës së parë ka gjetur se nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 11 i Ligjit themelor për punën (Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27) pasi që nuk është vërtetuar shkelja disiplinore nga ana e paditësit.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën ankimore, duke refuzuar ankesën e të paditurës në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje nga neni 215 të LPK-së, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën e vendosjes sipas ankesës së paditurës ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të paditësit, për të cilat ka dhënë arsye bindëse dhe të cilat janë të pranuar edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës, prandaj nuk qëndrojnë thëniet në revizion se gjykata e shkallës së dytë ka bërë shkelje nga neni 182 par. 2 pika (n) të LPK-së.

Në procedurë të zhvilluar nga gjykata e shkallës së parë e veçmas nga deklaratat e dëshmitarëve Sh. M., si dhe dëshmitarit I. H. dhe nga raporti i ekspertëve të Fakultetit Ekonomik prof. dr. M. A., prof.dr. S. A. dhe mr.sci. A. S., është vërtetuar fakti se paditësi nuk ka ndërhyrë në urdhëresat për punët jashtë orarit të punës. Veçmas vlen të theksohet fakti se grupi i ekspertëve nuk ka bërë vlerësimin e nënshkrimeve në urdhëresat për punë jashtë orarit të punës, por vetëm ka konstatuar se në ato urdhëresa nuk ka ndërhyrje dhe të njëjtat i kanë nënshkruar personat e autorizuar te e

paditura, që nga deklaratat e dëshmitarëve I. H., si udhëheqës drejtpërdrejtë i paditësit dhe Sh. M., është vërtetuar se këto urdhëresa për punë jashtë orarit të punës i kanë nënshkruar këta dëshmitarë , si përgjegjës drejtpërdrejtë të paditurës. Prandaj, thëniet e revizionit se paditësi ka ndërhyrë në këto lista, nuk qëndrojnë.

Paditësit në bazë të nenit 36 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës i është e garantuar e drejta në punë dhe në asnjë mënyrë kjo e drejtë nuk mund t'i mohohet dhe cenohet, meqenëse nga ana e të paditurës , në procedurën disiplinore është vërtetuar përgjegjësia disiplinore për një vepër që nuk e ka kryer, të njëjtit i është shkelur e drejta për punë dhe se gjykata në këto raste ofron mbrojtje gjyqësore për një shkelje të garantuar me ligj dhe me Kushtetutë, e cila nga ana e të paditurës është shkelur. Paditësi ka provuar në procedurën gjyqësore se ai nuk ndërhyrë në urdhëresat jashtë orarit të punës, prandaj as që mund të ngarkohet dhe të jetë përgjegjës për një veprim të cilin nuk e ka bërë, thëniet e revizionit se paditësi nuk ka provuar të vërtetojë se i njëjti nuk ka falsifikuar nënshkrimet, nuk qëndron.

Pjesa e dispozitivit të aktgjykimit me të cilën obligohet e paditura që paditësit t'ia njohë të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës në këtë pjesë është i pakjart dhe se nga i njëjti nuk mund të vërtetohet me çfarë të drejta kemi të bëjmë nga marrëdhënia e punës dhe si i tillë aktgjykimi në këtë pjesë është i papërshtatshëm për përmbartim .

Në vendosje të serishme në këtë pjesë gjykata e shkallës së parë duhet të kërkojë që paditësi të precizojë kërkesën e tij për shkak ndërprerjes kundërligjshme të marrëdhënies së punës, çfarë të drejta nga marrëdhënia e punës kërkon nga e paditura

Në bazë të asaj që u tha më sipër u vendos si nën pikën I dispozitivit në kuptim të nenit 224.2 të LPK, ndërsa në pjesën nën pikën II dispozitivit në kuptim të nenit 222 të LPK.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.36/2018 datë 18.6.2018

Kryetari i kolegjit,
Erdogan Haxhibeqiri